

**Kapitulli I**  
**EMËRTIMI, OBJEKTI, SELIA, KOHËZGJATJA**

**Neni 1**  
*Emërtimi*

Nëpërmjet këtij akti, sot në datën 9 Qershor 2023, është themeluar një Shoqëri me Përgjegjësi të Kufizuar me emërtimin **QUANT**.

Shoqëria është Person Juridik shqiptar sipas Ligjit Nr. 9901, datë 14.04.2008, “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”.

Shoqëria e ushtron aktivitetin e saj në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe me dispozitat e parashikuara në këtë Statut.

**Neni 2**  
*Selia*

Shoqëria e ka selinë në:

**Rruga Brigada VIII, Pallati LID, Kati 4, ap 1, Tiranë, Shqipëri**

Me vendim të organit administrativ, shoqëria mund të hapë degë ose zyra përfaqësimi brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë.

**Neni 3**  
*Mbi kohëzgjatjen e shoqërisë*

Kohëzgjatja e Shoqërisë është pa afat.

**Neni 4**  
*Objekti*

Shërbime Marketingu dhe telemarketingu, të të gjitha formave përfshirë këtu edhe publiciteti e marketingu duke përdorur metoda inovative, të komunikimit në distancë, të përdorimit të teknologjive të reja, të mediave, të formave tradicionale të telefonisë e çdo mënyre tjetër të ligjshme. Distributor i produkteve dhe materialeve promocionale - Prodhim, tregtim, marrje përfaqësisë brenda dhe jashtë vendit. Mbledhja, e perpunimi e menaxhimi i të dhënave, realizimi i sondazheve e studimeve të ndryshme. PR marrdhënie me publikun. Shërbime ndërmjetësimi biznesi, broker, duke synuar nxitjen e informacionit tregtar. Shërbime ndërmjetësimi për shitblerjen e pasurive të patundshme, përfshirë blerjet, shitjet dhëniet me qira, administrimin e pronave si troje, toka, ndërtesa, apartamente, brenda dhe jashtë territorit të Shqipërisë. Ushtrimi i aktiviteteve në fushën e turizmit.

**Neni 5**

*Mbi Themeluesin*

Shoqëria themelohet nga **Z. Regon Baze**, shtetas shqiptar, lindur me 07.01.1996 ne Tiranë, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar.

Në përputhje me Ligjin “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” si dhe me dispozitat e këtij Akt Themelimi dhe Statuti, në Shoqëri mund të përfshihen dhe ortakë të tjerë, të cilët bëhen zotërues të pjesëve të caktuara të kapitalit.

**Kapitulli II**

**KAPITALI DHE KUOTAT**

**Neni 6**

*Mbi Kapitalin Themeltar*

Kapitali themeltar i shoqërisë është përcaktuar në shumën 100 (njëqind) lekë. Kapitali themeltar ndahet në 1 kuotë me një vlerë nominale prej 100 (njëqind) lekë.

Ortaku Regon Baze zotëron 100 përqind të kuotave të kapitalit.

Ortaku ka të drejtën e informimit mbi aktivitetin e Shoqërisë.

Ortaku vendos për rritjen e kapitalit themeltar.

**Kapitulli III**

**ORGANET E SHOQËRISË**

**Neni 7**

*Ortaku i Vetëm*

Mbledhja e Ortakut të Vetëm rregullisht e thirrur, përfaqëson tërësinë e ortakëve dhe vendimet e saj të marra sipas ligjit dhe sipas këtij Akt Themelimi dhe Statuti, detyrojnë të gjithë ortakët.

Ortaku i Vetëm mblidhet të paktën një herë në vit, brenda javës së tretë të muajit Maj.

Administratori drejton mbledhjen e Ortakut të Vetëm. Në rastet kur ai nuk dëshiron të ushtrojë një rol të tillë, atëherë Ortaku i Vetëm e drejton mbledhjen.

**Neni 8**

*Organi Ekzekutiv*

Organi ekzekutiv i shoqërisë është Administratori.  
Administrator i shoqërisë emërohet **Z. Regon Baze** për një periudhë 5 vjeçare.

**Kapitulli IV**

**PASQYRAT FINANCIARE DHE DIVIDENDËT**

**Neni 9**

Viti ekonomik fillon në 1 Janar dhe mbyllet në 31 Dhjetor të çdo viti dhe Pasqyrat Financiare duhet të miratohet brenda gjashtë muajve që vijnë.

Përfundimisht, viti i parë ekonomik fillon në datën e regjistrimit në regjistrin tregtar dhe mbyllet në 31 Dhjetor 2023.

**Neni 10**

Në mbyllje të çdo viti ekonomik, organi administrativ, brenda tre muajve duhet të procedojë në përgatitjet e Pasqyrave Financiare të Shoqërisë të cilat përshkruajnë më së miri gjendjen financiare, performancën, ndryshimet në gjendjen e kapitalit dhe flukset e parasë.

Pasqyrat Financiare duhet të shoqërohen nga një relacion i organit ekzekutiv që bën të qartë ecurinë e administrimit në sektorë të ndryshëm në të cilët Shoqëria ka vepruar, edhe me shoqëritë e tjera që kontrollohen prej saj, me një kujdes të veçantë si për investimet, për kostot dhe për çmimet ashtu edhe për faktet me rëndësi që janë vërtetuar pas mbylljes së veprimtarisë.

**Neni 11**

Pasqyrat Financiare dhe relacioni i organit ekzekutiv duhet të mbeten të depozituar pranë selisë së Shoqërisë 15 ditë para mbledhjes së Ortakut të Vetëm që thirret për t'i aprovuar ato, gjatë së cilës ortaku mund të kërkojë e të shqyrtojë kopje me shpenzimet e tij.

Këto dokumenta duhet të jenë në dispozicion të ekspertëve kontabël të regjistruar në qoftë se janë të emëruar, të paktën 40 ditë para mbledhjes së Ortakut të Vetëm që duhet t'i aprovojë.

**Neni 12**

Të ardhurat neto duhet ti shpërndahen ortakut si dividend, përjashto rastin kur Ortaku i Vetëm vendos për destinime të tjera.

Pagesa e dividendëve duhet të bëhet duke hyrë në fuqi nga data e caktuar nga mbledhja e Ortakut të Vetëm që ka vendosur shpërndarjen e tyre.

Në mungesë të përcaktimit të datës së pagesës së dividendëve, këta do të jenë në dispozicion të ortakëve pranë arkës së selisë së Shoqërisë që nga dita e 30 pas marrjes së vendimit të shpërndarjes së dividendëve.

Dividendët që nuk janë tërhequr brenda pesë vjetëve duke filluar nga dita që janë bërë të pagueshëm parashkruhen në fondin e Shoqërisë dhe kalojnë në fondin rezervë.

**Kapitulli V**  
**DISPOZITA TË TJERA**

**Neni 13**


Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin do të zgjidhen me mirëkuptim, në të kundërt do të zgjidhen nëpërmjet organeve të posaçme të njohura nga ligji.

**Neni 14**

Për ato që nuk janë shprehur në këtë Akt Themelimi dhe Statut do të bëhet referim me dispozitat e Ligjit në fuqi.

Ky Akt Themelimi dhe Statut është hartuar në 1 (një) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe kjo kopje origjinale qëndron në dokumentacionin baze të shoqërisë.

**ORTAKU THEMELUES**

  
Regon Baze